



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 3549 prot.

Tiranë, më 10.09.2021

URDHËR

Nr 127, datë 10.09.2021

“PËR

**PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMIN E DHËNIES SË
INFORMACIONIT OSE DOKUMENTACIONIT ME KËRKESË PRANË ZYRËS SË
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË.”**

Në mbështetje të nenin 204 germa “c” e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të neni 13 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

URDHËROJ:

1. Caktimin e shërbimeve me pagesë dhe kostos për riprodhimin e lëshimin e kopjeve të dokumenteve të administruara nga Zyra e Inspektorit të lartë të Drejtësisë, me synimin:
 - a) bërjen transparente të kostove të riprodhimit të dokumenteve apo përcjelljen e tyre;
 - b) ofrimin e një tarife të bazuar mbi koston mesatare për këtë lloj shërbimi;
 - c) zbatimin e tarifave të unifikuara për llojet dhe sasinë e dokumenteve;
 - d) përjashtimin nga pagesa e tarifave të kategorive të caktuara;
2. Tarifat e përcaktuara aplikohen ndaj kërkesave të publikut, personave fizikë e juridikë, që kanë për objekt vënien në dispozicion të dokumenteve të dorëzuar prej tyre në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Tarifa përfshin koston e riprodhimit të informacionit të kërkuar (dokumentacionit) dhe e dërgimit të tij, në rast se kjo kërkohet nga personi i interesuar.
4. Tarifat për dhënien e informacionit (dokumentacionit) përlllogariten si më poshtë:
 - a) Deri në 10 fletë bardhë e zi, informacioni përfitohet pa pagesë.
 - b) Mbi 10 fletë bardhë e zi, për formatin A4, pagesa do të jetë 5 (pesë) lekë për fletë.

- c) Për informacionin e dhënë me CD, pagesa do të jetë 60 (gjashtëdhjetë) lekë për CD
 - d) Për shërbimin postar 200 lekë për çdo shërbim brenda vendit.
5. Pas marrjes së kërkesës nga subjekti kërkuar, sektori i Buxhetit dhe Financës në bashkëpunim me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, llogarit shumën që duhet paguar për riprodhimin dhe sipas rastit, për dërgimin e informacionit dhe njofton menjëherë kërkuarësin për kryerjen e pagesës.
 6. Pagesa e tarifës nga kërkuarësi bëhet në lekë, në një bankë të nivelit të dytë, duke tërhequr më parë kopjen e faturës së arkëtimit të miratuar, pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Çdo tarifë e paguar depozitohet në Buxhetin e Shtetit.
 7. Me pagesën e tarifës përkatëse dhe paraqitjen e mandatit bankar/ të arkëtimit, pranë Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, dokumentet e kërkuara dërgohen me postë ose i dorëzohen kërkuarësit.
 8. Riprodhimi i dokumenteve të kërkuara do të bëhet me mjetet e riprodhimit që disponon Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
 9. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike është pa pagesë.
 10. Përjashtohen nga pagimi i tarifës personat e regjistruar në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, të cilët përfitojnë informacionin (dokumentacionin) pa pagesë deri në 20 fletë ose deri në 4 CD, pas vërtetimit të statusit përkatës.
 11. Ndalohet shumëfishimi për qëllime shitje të informacionit ose dokumentacionit, të marrë sipas përcaktimeve të këtij urdhri.
 12. Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse ngarkohet për zbatimin, njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri, në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani